

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË OPERATORIN E SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT NË PROJEKTIN NDËRTIMI I LINJËS 400KW TIRANË-
PODGORICË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, në Projektin Ndërtimi i linjës 400 kw Tiranë-Podgoricë, me objekt “Mbi kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlerësimit të zbatimit të projektit” për periudhën nga fillimi i projektit deri-në 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 73 datë 17.05.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 177/6 datë 17.05.2012, dërguar Z. Arben Ibroja, Administrator i Sistemit të Transmetimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të merren masa nga SHA OST për rishikimin dhe rakordimin e pagesave të kryera dhe pretendimeve (Claim), me kontraktin [REDAKTUAR] dhe kompanisë konsulente [REDAKTUAR] për pjesën e mbetur të kredisë, të hartojë një planifikim për disbursimet e kredisë, sa më të saktë dhe pa rezerva, pasi për periudhën objekt kontrolli planifikimi nuk ka qenë i saktë dhe në vitet e para të projektit ai ka qenë fiktiv me penalitet **348,935 euro** nga KfW (trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

2- Të merren masa nga SHA OST për rakordimin e shumës **185,000 euro, dëm ekonomik** të likuiduara kontraktorit [REDAKTUAR], si diferencë midis shumave të likuiduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave (kjo referuar deklaratave doganore), trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

3- Të merren masa nga SHA OST për rakordimin me Organet Tatimore për sistemimin e vlerës **4,772,784 lekë** diferenca midis TVSH-së së paguar sipas Deklaratës Doganore dhe asaj që realisht duhej të paguante OST SHA, (trajtuar më hollësisht në pikën III të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

4. Të marren masa nga SHA OST për rakordimin e shumës **171,540.83 euro dëm ekonomik** të likuiduara kompanisë konsulente [REDAKTUAR], shërbime konsulence shtesë të pa justifikuara pasi kanë qenë detyra që do të kryheshin nga kompania konsulente përcaktuar në kontratën e lidhur Aneksi 2. Pika 3 Metoda dhe Metodologjia e propozuar, pika 3.3 Faza I-Faza e para-ndërtimit. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

5- Të merren masa nga SHA OST në bashkëpunim me KfW për plotësimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit për kontratat e lidhura për “Shërbime konsulence për Linjën e interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë” si dhe kontratës

“Ndërtim i Linjës së interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë”. trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

6- Të merren masa nga SHA OST për rakordimin e shumës **2,474.2 euro, dëm ekonomik** të likuiduara kontraktorit [REDACTED] vlera e elementeve që mungojnë në materialet e dorëzuara në N/stacionin Rrashbull. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

7- Të merren masa nga SHA OST për verifikimin e ekzistencës së bazamentit nxjerrë të pa përdorshëm nga spostimi i shtyllës 211 Milot, **me vlerë 18,532.53 euro**, në të kundërt të kërkohet shpërblimi i dëmit në këtë vlerë nga kontraktori [REDACTED] (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

8- Të merren masa nga SHA OST për përfundimin e punimeve të pakryera të përcaktuara në kontratën e lidhur me kompaninë [REDACTED] për futjen në sistemin e miniskades të Linjës 400 kV Tirana 2 dhe të Shinalidhesit 400 kV në N/st Elbasan 2. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

9. Të merren masa nga SHA OST, për inventarizimin e dosjeve e projektit “Ndërtimi i Linjës 400 KV Tiranë –Podgoricë” dhe të bëhet arkivimi i tyre në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

10. Të merren masa nga SHA OST në bashkëpunim me KfW për përfundimin dhe marrjen e një vendimi sa më të shpejtë të fituesit të kontratës së ndërtimit “Linja e transmetimit 400kV Shqiperi Kosove”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1- T’i kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OST SHA, shpërblimi i dëmit në vlerën **20,513 euro, shkaktuar** [REDACTED] Titan në Burizanë në kampionatën 248-249, ardhur si pasojë e plasjeve me material eksploziv gjatë punimeve në Fabrikën e Çimentos. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

2- T’i kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga OST SHA, shpërblimi i dëmit në vlerën **34 320 euro**, [REDACTED] ardhur si pasojë e aksidentimit të automjetit tip TOYOTA RAV 4. (trajtuar më hollësisht në pikën IV të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kontratën Kolektive të punës datë 01.06.2010 dhe nenin 10 të Kontratës Individuale të Punës nënshkruar midis palëve me datën 01.01.2011, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Pushim nga puna”

- Për [REDAKTUAR] me detyrë Shef Zyre, Administrimit të tregut në Drejtorinë e Tregut me cilësinë ish-Shef i PIU-t.

1. Për mos zbatim të Marrëveshjes Financiare dhe mosimplementim në kohë të projektit, penalizuar dhe nga Banka KfW në vlerë 348 935 Euro.
2. Për mos analizim të penaliteteve nga Banka KfW mbi arsyet dhe përgjegjësite reale të cilat ka sjellë një situatë të tillë, përveç faktit të mbajtjes nga ana e Financës së evidencave të sakta dhe shlyerjes së tyre.
3. Për mos administrim dhe dorëzim të dokumentacionit të projektit në përfundim të detyrës në arkivën e OST sh.a, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Për mos bashkëpunim me KfW për plotësimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit për kontratat e lidhura për “Shërbime konsulence për Linjën e interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë” si dhe kontratës “Ndërtim i Linjës së interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë”.
5. Për lidhjen e amendamenteve të kontratës së ndërtimit nr. 1 datë 05.06.2008, me vlerë – 484,736.88 euro dhe nr. 2, datë 27.05.2009 me vlerë 265,346.19 euro pa autorizim nga drejtori i përgjithshëm i OST sha, në kundërshtim me nenin 22.6 të Statutit të OST sha.
6. Për likuidim kontraktorit “DALEKOVOD të mallrave me diferencë **185,000 euro, dëm ekonomik** midis shumave të likujduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave (kjo referuar deklaratave doganore).
7. Për raportim të rremë në Organet Tatimore të TVSH-së së paguar sipas Deklaratës Doganore dhe asaj që realisht duhej të paguante OST SHA, në vlerën **4,772,784 lekë**.
8. Për blerjen e dy automjeteve në vlerën 71,520 euro (përcaktuar në Amendamentin nr.1), duke e pasqyruar dhe likuiduar si punime civile dhe jo blerje malli, në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur dhe Marrëveshjen.
9. Për lidhjen fiktive të kontratës së blerjes së automjetit Automjeti TOYOTA, tipi Rav 4 me date 27.11.2008, pasi ky automjet është blerë pas aksidentimit të makinës.
10. Për lënien pa asnjë dokument shoqërues të automjetit të aksidentuar, në një nga garazhet e Njësisë së Mirëmbajtjes e Transmetimit të OST sha në vlerën **34 320 euro**.

(Shih procesverbalet nr. 1, date 23.03.2012, nr. 2 datë 23.03.2012, nr. 3, datë 23.03.2012, nr. 4, datë 23.03.2012, nr. 5, datë 23.03.2012 dhe aktverifikimin nr. 1, datë 23.03.2012).

-“Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë deri në një vit”

- Për [REDAKTUAR] me detyrë Shefe Njësie në Njësinë e Menaxhimit të Projekteve në Drejtorinë e Projektim Zhvillimit.

1. Për mos zbatim të Marrëveshjes Financiare dhe mosimplementim në kohë të projektit, penalizuar dhe nga Banka KfW në vlerë 348 935 Euro.
2. Për mos analizim të penaliteteve nga Banka KfW mbi arsyet dhe përgjegjësite reale të cilat ka sjellë një situatë të tillë, përveç faktit të mbajtjes nga ana e Financës së evidencave të sakta dhe shlyerjs së tyre.

3. Për likuidim kontraktorit “DALEKOVOD të mallrave me diferencë **185,000 euro, dëm ekonomik** midis shumave të likujduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave (kjo referuar deklaratave doganore).

4. Për raportim të rremë në Organet Tatimore të TVSH-së së paguar sipas Deklaratës Doganore dhe asaj që realisht duhej të paguante OST SHA, në vlerën **4,772,784 lekë**.

(Shih procesverbalin nr. 2, datë 23.03.2012 dhe aktverifikimin nr. 1, datë 23.03.2012).

Ç. KALLZIM PENAL

1. Për [REDAKTUAR] me cilësinë ish-Shef i PIU-t OST sh.a

Për “Shpërdorim detyre”, parashikuar në nenin 248, të Kodit Penal, për shkeljet e konstatuara nga kontrolli i ushtruar në OST sh.a., ku janë vërejtur shkelje të dispozitave ligjore, mangësi në zbatimin e tyre, lidhur me:

- Mos zbatim të Marrëveshjes Financiare dhe mosimplementim në kohë të projektit, penalizuar dhe nga Banka KfW në vlerë 348 935 Euro.

- Mos analizim të penalteteve nga Banka KfW mbi arsyet dhe përgjegjësitë reale të cilat ka sjellë një situatë të tillë, përveç faktit të mbajtjes nga ana e Financës së evidencave të sakta dhe shlyerjs së tyre.

- Mos administrim dhe dorëzim të dokumentacionit të projektit në përfundim të detyrës në arkivën e OST sha në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Mos bashkëpunim me KfW për plotësimin dhe arkivimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimit për kontratat e lidhura për “Shërbime konsulence për Linjën e interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë” si dhe kontratës “Ndërtim i Linjës së interkonjeksionit 400 kv, Tiranë-Podgoricë”.

- Lidhjen e amendamenteve të kontratës së ndërtimit nr. 1 datë 05.06.2008, me vlerë – 484,736.88 euro dhe nr. 2, datë 27.05.2009 me vlerë 265,346.19 euro pa autorizim nga drejtori i përgjithshëm i OST sha, në kundërshtim me nenin 22.6 të Statutit të OST sha.

- Likuidimin e kontraktorit “DALEKOVOD të mallrave me diferencë **185,000 euro, dëm ekonomik** midis shumave të likujduara nëpërmjet kërkesave për disbursim dhe vlerës reale të mallrave (kjo referuar deklaratave doganore).

- Raportim të rremë në Organet Tatimore të TVSH-së së paguar sipas Deklaratës Doganore dhe asaj që realisht duhej të paguante OST SHA, në vlerën **4,772,784 lekë**.

- Blerjen e dy automjeteve në vlerën **71,520 euro** (përcaktuar në Amendamentin nr.1), duke e pasqyruar dhe likuiduar si punime civile dhe jo blerje malli, në kundërshtim me kushtet e kontratës së lidhur dhe Marrëveshjen.

- Lidhjen fiktive të kontratës së blerjes së automjetit Automjeti TOYOTA, tipi Rav 4 me date 27.11.2008, pasi ky automjet është blerë pas aksidentimit të makinës.

- Aksidentimin dhe lënien pa asnjë dokument shoqërues të automjetit të aksidentuar, në një nga garazhet e Njësisë së Mirëmbajtjes e Transmetimit të OST sh.a. në vlerën **34 320 euro**.

Si përfundim konkludojmë se referuar shkeljeve të mësipërme të shoqëruar me dëme dhe efekte financiare negative për OST sh.a, kërkojmë që të fillojë procedimi penal, për shpërdorim detyre për personin e mësipërm.

Shënim: Masa e largimit nga puna për z. [REDAKTUAR] znj. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR] quhen të ezauaruara pasi këta persona janë larguar nga OST dhe nuk punojnë në Administratë Publike.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mariola Lleshi, Albana Pengili, Elfrida Agolli, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i

Drejtore Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT